



Rregulloret që Ndikojnë në Privatizim dhe që Inkurajojnë Efikasitetin e Ndërmarrjeve

14 Prill 2008

Dean White

President

PA Government Services



National
Association of
Regulatory
Utility
Commissioners



Center for
Energy and Natural Resources

Perspektiva jonë

Disa parime themelore...

Për procesin e privatizimit të një ndërmarrje, jetësore është ekzistenca e një kornizë rregullative koherente, stabile dhe e parashikuar mirë.

Edhe pse ka shembuj që tregojnë për një privatizim të kryer përmes një kornize rregullative jo të zhvilluar mirë, përvojat e pas privatizimit tregojnë se dobësitë në kornizën rregullative shpesh shkaktojnë vështirësitë më të mëdha.

Perspektiva jonë

Duke ditur që qeveria në mënyrë aktive po e merr në konsideratë privatizimin, ky prezantim tregon për komponentët vendimtare rregullative që nevojiten për atë si vijon:

- ✓ Mbështetjen e objektivave për një proces të suksesshëm të privatizimit që do të vlerësohet jo vetëm përmes llojit të veprimeve që janë ndërmarr por edhe përmes sprovave të pas privatizimit
- ✓ Ngritjen e efikasitetit të shërbimeve të ndërmarrjes dhe kualitetit të shërbimeve me qëllim të sigurimit të një furnizimi kualitativ dhe të besueshëm që do të mbështes zhvillimet ekonomike dhe sociale, që do të jetë i arsyeshëm sa i përket kostos së furnizimit dhe i cili është në linjë me objektivat e qeverisë (p.sh. Mjedisi).

Perspektiva jonë bazohet në atë që të shërbejmë qoftë si operator të ndërmarrjeve publike dhe këshillëdhënës për privatizimin e ndërmarrjeve...

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#1 – Aranzhimet Institucionale:

- ✓ Një ligj (ligje) që mundëson rregullimin e sektorit i cili vendos:
 - Autoritetet e rregullatorit
 - Së paku bazat për një rregullativë pothuaj të pavarur (p.sh. Skema financiare duke promovuar pavarësinë gjatë vendimmarrjes)
 - Përcaktimin e përgjegjësive mes funksioneve politikë bërëse dhe rregullative.
- ✓ Korniza ligjore nuk është temë për amandamente të shpeshta, pra është relativisht stabile.
- ✓ Institucioni rregullativ të ketë shënime gjatë së paku disa viteve të kaluara për të mundësuar një shkallë të caktuar të komoditetit lidhur me atë se si funksionon rregullatori.
- ✓ Rregullatori të shihet të jetë trajnuar dhe i aftë në praktikat e rregullativës.

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#2 - Transparenca:

- ✓ Definim i qartë i procedurave në lemitë si vijon:
 - Grumbullimin dhe dokumentimin e qartë të proceseve vendimmarrëse (më shumë si një proces në gjykata, më pak si një dekret)
 - Pjesëmarrja dhe kontributi i palëve të interesuara gjatë diskutimeve rregullative
 - Proceset dëgjimore dhe pjesëmarrja e opinionit
- ✓ Vendimmarrja të duket të jetë:
 - E bazuar në faktet e paraqitura
 - Plan kontabël koherent – i audituar nga ana e rregullatorit – si bazë e shqyrtimeve të shpenzimeve dhe atyre tarifore
 - Pa ndërhyrje nga jashtë i qeverisë apo palëve tjera të interesuara në procesin e vendimmarrjes.

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#3 – “Praktikaliteti” i Rregullatorit:

- ✓ Rregullatori duhet të njeh kompleksitetin e proceseve të caktuara të reformave, pa bërë kërkesa të pa arsyeshme nga ndërmarrja
- ✓ Pa ndërhyrje në çështjet operacionale të ndërmarrjes përveç atyre përmes auditeve rregullative, shqyrtimeve tarifore dhe të tjera që lidhen me shpenzimet në ndërmarrje
- ✓ Rregullatori duhet parë të jetë realist – p.sh. të i shmangët futjes së një strukture tarifore të komplikuar të cilën nuk mund ta përcjell infrastruktura matëse.

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#4 – Principet Tarifore:

- ✓ Bazat për vendosjen e tarifave duhet të shihen nga ana e investorëve si:
 - Transparente dhe relativisht të thjeshta
 - Ekonomikisht efikase
 - Që reflektojnë kostot
 - Stabile/mënyra e parashikimit drejt mbulimit të plotë të kostove
 - Të drejta për konsumatorë
 - Promovojnë zgjerimin e sistemit energjetik.
- ✓ Sistemi tarifor duhet të reflektojë mbulimin e kostove për komponente të ndryshme të kërkesave të të hyrave të cilat janë jashtë kontrollit të ndërmarrjes, p.sh. ndryshimet në shkallën këmbimore, ndikimi nga ndryshimet ligjore.
- ✓ Pa shfrytëzim të dukshëm të sistemit tarifor në adresimin e mbrojtjeve sociale.

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#5 – Struktura Tarifore:

- ✓ Caktimi i çmimeve sipas qasjes “Kostot-Plus”: Kjo qasje mbështetet në konceptin që kostot të cilat një monopolist me maturi i bënë gjatë ofrimit të shërbimeve për konsumator do të duhej të lejoheshin që të mbulohen përmes tarifave së bashku me një profit “të drejt”.
- ✓ Rregullimi “Sipas Standardeve”: Në disa instanca (kryesisht të rralla), do të ishte e arsyeshme që çmimet për shërbimet të caktohen në bazë të çmimeve të tregut për shërbimet e njëjta në një treg të barabartë. Kjo qasje zvogëlon barrën që ka rregullatori lidhur me caktimin e çmimeve sipas qasjes “kostot-plus”.
 - Kjo qasje ishte përdorur për rregullimin e çmimeve të gjenerimit në Skotlandë gjatë viteve 1990-ta sipas standardeve në tregun Anglez dhe atij te Vellsit.
- ✓ Rregullativa “Nxitëse”: Sot po rritet numri i rregullatorëve që po shtojnë elementet stimuluese – zakonisht skema që lejojnë ndarjen e benefiteve të kostove apo rritjes së performancës mes konsumatorëve dhe entitetit të rregulluar. Këto aranzhime nxitëse zakonisht lidhen me rregulloren sipas qasjes kosto-plus apo atë të çmimeve të tregut.

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#5 – Struktura Tarifore (vazhdim):

Viteve të fundit, vargu i qasjeve të ndryshme është zhvilluar me qëllim të mundësimit të stimulimeve në rastet e rezultateve të mira nga ana e entiteteve të rregulluara, qasje këto që do të ishin të dobishme për marrje në konsideratë gjatë privatizimit si:

- ✓ Skemat Shpërblyese/Ndëshkuese Bazuar në Rezultatet e Punës: Identifikimi i parametrave teknik të matshëm (që mund të kontrollohen) dhe negocimi i shpërblimeve apo ndëshkimeve financiare për rezultate më të mira apo më të këqija se sa caqet e caktuara.
 - Kjo qasje është përdorur për të mundësuar stimulime me qëllim të minimizimit të humbjeve në sistemin e bartjes dhe kostove të shërbimeve mbështetëse në Angli.
 - Skema të tilla zakonisht kërkojnë përvojë të mjaftueshme, “bazë” për negociim të niveleve të arsyeshme të caqeve të caktuara.
- ✓ “Tavani i Çmimit” apo “Tavani i të Hyrave”: Si alternativë / zëvendësim i qasjes “kosto-plus”, këto teknika para së gjithash ngrijnë mënyrën e caktimit mesatar të çmimeve (apo të hyrave totale) duke ju lejuar entiteteve të rregulluara stimulime të profitit me qëllim të përgatitjes dhe zbatimit efikas të punëve.

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#6 – Rregullat e Tregut dhe Tregtisë:

- ✓ Bazat për aranzhimet tregtare komerciale në sektor duhet të jenë të qarta. Kjo përfshinë:
 - Strukturën e Sektorit
 - Aranzhimet kontraktuale
 - Aranzhimet e blerjes së energjisë elektrike
 - Kërkesat për privilegje dhe niveli i ekskluzivitetit
 - Njohjen e shërbimeve mbështetëse
 - Monitorimi i tregut për parandalimin e keqpërdorimeve
 - Të vendoset politikat e planeve
- ✓ Rregullat e tregut dhe tregtisë duhet të shihen të jenë relativisht stabile me ndryshime të bëra vetëm pas procesit të konsultimeve të gjëra dhe të hapura me të gjitha palët e interesuara.

Nevojat Rregullative për Mbështetjen e Procesit të Privatizimit

#7 – Pjesëmarrja e Rregullatorit në Proces:

- ✓ Rregullatori duhet të merr pjesë në procesin e privatizimit apo, në minimum, të konsultohet për gjatë procesit.
 - Edhe pse kjo duket mese e dukshme, nganjëherë kjo është injoruar gjë e cila mund të shkaktojë shqetësime për investitorët potencial dhe rritjen e ndenjës së riskut.
- ✓ Rregullatori duhet të shihet si balancues i interesit të investitorëve dhe konsumatorëve potencial. Theksim i tepërt ndaj konsumatorëve – apo edhe më keq, deklarata të fuqishme populiste – do të rrisin ndjenjën e riskut të pronësisë, me gjasa për kërkesa shtesë të investitorëve dhe uljen e vlerës së qeverisë dhe opinionit në tërësi gjatë procesit të privatizimit.

Çfarë dëshironi të shmangni...



Po, kjo është vetëm një kontratë e privatizimit, në 59 vëllime... është dashur të definohen procedurat dhe principet kryesore për shkak të mangësive në kornizën dhe institucionet rregullative ...